



Veprimet ligjore ndaj autoriteteve publike: Ankesat për shërbimet e energjisë dhe ujit në gjykatë

Hyrje

Në një shoqëri demokratike, qytetarët kanë të drejtën themelore për të mbajtur përgjegjëse autoritetet publike, përfshirë edhe në çështjet që lidhen me shërbimet publike. Kur qytetarët besojnë se janë trajtuar padrejtësisht nga institucionet publike, qoftë përmes faturimeve të pasakta, mohimit të shërbimeve, apo veprimeve të tjera administrative, ata kanë të drejtën e tyre të kërkojnë zgjidhje ligjore. Në Kosovë, kjo e drejtë përfshin mundësinë e paditjes së autoriteteve publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ky proces siguron që edhe në rastet që përfshijnë shërbime publike thelbësore, si furnizimi me energji dhe ujë, qytetarët të mund të sfidojnë vendimet që i prekin negativisht dhe të kërkojnë drejtësi përmes sistemit ligjor.

Qëllimi kryesor i këtij raporti të shkurtër është të kuptojë se si trajtohen këto lëndë në gjykatë në rastet e padrejtësive nga ana e organeve publike. Raporti fillon me përshkrimin e procedurës së ankesës, vijon me ilustrimin e dy rasteve të monitoruara në gjykatë dhe përfundon me rekomandime. Në këto dy raste, qytetarët kanë ngritur padi ndaj institucioneve publike: në rastin e parë, ndaj Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për një borxh të kontestuar për energji elektrike; dhe në rastin e dytë, ndaj Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh.a. (KRU "Prishtina") dhe Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) për një borxh të papaguar për shërbimet e ujit.

Këto tri entitete ZRRE, KRU "Prishtina" dhe ARRU, të përcaktuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, rregullojnë fusha të ndryshme në sferën publike dhe ofrojnë shërbime për qytetarët. Raste të tilla tregojnë sfidat procedurale dhe ligjore me të cilat përballen qytetarët kur kërkojnë zgjidhje për ankesat e tyre ndaj ofruesve të shërbimeve publike.

Procedura e ankesës administrative

Këto raste gjykata i trajton sipas procedurës administrative gjyqësore, e cila është e rregulluar me Ligjin për Konfliktet Administrative. Sipas këtij ligji, konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. Po ashtu, konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative, nuk është lejuar ankesa¹.

Në rastin e parë, pala paditëse ka paditur Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE), një organ i pavarur përgjegjës për rregullimin e aktivitetëve në sektorin e energjisë në Kosovë. Ndërsa në rastin e dytë, të paditur janë Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” sh.a. (KRU “Prishtina”), një ndërmarrje publike në pronësi të Qeverisë së Kosovës, e cila ushtron të drejtën e aksionarit përmes bordeve të zgjedhura, si dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), një autoritet i pavarur përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë.

Lidhur me këtë rast, pala paditëse kishte bërë një ankesë fillimisht në ZRRE për të kontestuar një borxh për energji elektrike që e konsideronte të pasaktë dhe të bazuar në llogaritje të gabuara për një periudhë shtatë vjeçare. Pas marrjes së vendimit të shkallës së parë nga ZRRE, pala paditëse paraqiti një ankesë në Bordin e ZRRE-së, i cili sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, mbikëqyr dhe organizon punën e ZRRE-së². Edhe në këtë organ të shkallës së dytë, ankesa e palës u refuzua. Pala, e pakënaqur me vendimin e bordit, e dërgoi çështjen në gjykatë.

Në rastin e dytë, pala kishte bërë një kërkesë për regjistrimin e një orëmatësi të ri te KRU “Prishtina”. Kjo kompani e refuzoi këtë kërkesë, duke sqaruar se pala kishte një borxh të papaguar për një periudhë të caktuar dhe se regjistrimi i orëmatësit nuk mund të bëhej pa shlyerjen e borxhit. Pala, duke e konsideruar borxhin si të padrejtë pasi kishte blerë një pronë të re, bëri ankesë në ARRU, duke argumentuar se borxhi i takonte pronarit të mëparshëm. ARRU, si organ i shkallës së dytë, e miratoi pjesërisht ankesën, por pala mbeti e pakënaqur dhe vendosi të vazhdojë rrugën ligjore në gjykatë.

Në të dy rastet, vetëm pasi janë shterur të gjitha mundësitë e apelimit në nivelin administrativ, palët kanë paraqitur padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Rasti 1

Padia e Sh.B. ndaj Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE)

Në rastin e parë, Gjykata Themelore në Prishtinë ka shqyrtuar padinë e ngritur nga paditësi Sh. B., kundër Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), për ankesat lidhur me faturimin e energjisë elektrike.

Paditësi Sh.B, më 14 shtator 2022, ka kërkuar që gjykata të anulojë vendimet e ZRRE-së dhe të bordit të kësaj zyre lidhur me një borxh të kontestuar për energji elektrike. Sipas padisë, ky borxh, në shumën prej 13,549.17 euro, ishte i bazuar në llogaritje të pasakta, duke e ngarkuar financiarisht pa të drejtë paditësin për periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2017.

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707>

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L-084. Ligji për Rregullatorin e Energjisë. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694>

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më 27 dhjetor 2023, ku morën pjesë paditësi Sh.B. me përfaqësuesin e tij ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar ligjor i ZRRE-së, P.H., gjykata konstatoi se vendimet e ZRRE-së dhe bordit të saj ishin marrë në kundërshtim me ligjin. Gjykata theksoi se aktet administrative nuk përmbanin arsyetim të duhur dhe ishin të pasakta në konstatimet faktike dhe ligjore. Gjithashtu, u konfirmua se fatura e kontestuar bazohej në një gabim të llogaritjes, për të cilin ZRRE-ja dhe Bordi nuk kishin ofruar prova të mjaftueshme për të justifikuar borxhin.

Gjykata vuri në pah se vendimi i kontestuar përmbante të meta të tilla që e pengonin shqyrtimin e ligjshmërisë së tij. Këto të meta konsistonin në shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Këto shkelje përfshinin veçanërisht nenet 47 dhe 48 të këtij ligji, të cilat kërkojnë që aktet administrative të përmbajnë, ndër të tjera, një përmbledhje të konstatimeve faktike të bazuara në prova, një deklaram të bazës ligjore, si dhe një arsyetim të qartë për secilin vendim³.

Lidhur me këtë rast, gjykata me një aktgjykim vendosi që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulojë vendimet e kontestuara. Vendimet e ZRRE-së dhe të bordit të saj, u shpallën të paligjshme dhe lënda u kthye për rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. Gjykata e urdhëroi ZRRE-në të veprojë në përputhje me vërejtjet e dhëna, të rishqyrtojë rastin sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të ofrojë një vendim të drejtë dhe të arsyetuar për borxhin e paditësit⁴. Rasti është ende në proces. Pas vendimit të gjykatës themelore, ZRRE ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar se gjendja faktike ishte vërtetuar gabimisht dhe se e drejta materiale ishte zbatuar në mënyrë të pasaktë. Aktualisht, pritet vendimi nga shkalla e dytë.⁵

Rasti 2

Padia e B.R. ndaj Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” sh.a. (KRU “Prishtina”), dhe Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU)

Në rastin e dytë, paditësi B.R. më 23 nëntor 2021 kishte paditur Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” sh.a. (KRU “Prishtina”), dhe Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU), duke kontestuar vendimet e tyre lidhur me një borxh të papaguar për shërbimet e ujit, i cili lidhej me një pronë të blerë nga paditësi B.R. Paditësi kërkonte anulimin e vendimeve që e detyronin të marrë përgjegjësinë për një borxh që i përkiste pronarit të mëparshëm.

Mosmarrëveshja lindi pasi paditësi bleu një parcelë kadastrale në një lagje të Prishtinës, ku prishi ndërtesën ekzistuese dhe ndërtoi një shtëpi të re. Sipas paditësit, ai fillimisht kërkoi nga KRU “Prishtina” instalimin e një ujëmatësi të ri, por u njoftua se duhej të paguante një borxh të papaguar që datonte që nga viti 2000. Vetëm pas shlyerjes së këtij borxhi, paditësit do t’i instalohet ujëmatësi. Paditësi e kundërshtoi këtë borxh, duke argumentuar se nuk ishte përgjegjës për të, pasi i përkiste ish-pronarit të parcelës. Ai gjithashtu pretendoi se borxhi ishte llogaritur gabimisht dhe nuk përbënte detyrim për të, pasi asnjëherë nuk ishte dërguar ndonjë faturë në adresën e tij.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 47 dhe 48. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

⁴ Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.2202/2022, datë: 04.01.2024.

⁵ Komunikim elektronik me Shpresa Musliu, Analiste për Përmbushje të Standardeve në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve, ZRRE. Datë: 04.09.2024.

Paditësi B.R. e kundërshtoi vendimin e shkallës së parë, KRU “Prishtina” duke paraqitur ankesë në shkallën e dytë, ARRU. Ky organ aprovoi pjesërisht ankesën e palës, duke anuluar vendimin fillestar të KRU “Prishtina”, por përsëri duke kërkuar nga paditësi që të paguante një pjesë të borxhit për periudhën 2018-2019. I pakënaqur me këtë vendim, paditësi ngriti padi në gjykatë, duke kërkuar përjashtim të plotë nga borxhi dhe të drejtën për regjistrimin e ujëmatësit në emrin e tij.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 22 mars 2024, në të cilën morën pjesë paditësi B.R. dhe përfaqësuesi i të paditurit D.H. nga ARRU, si dhe në mungesë të palës së paditur KRU “Prishtina”, gjykata administroi provat relevante, duke përfshirë dokumentet financiare, dhe analizoi kuadrin ligjor. Pas shqyrtimit, gjykata arriti në përfundimin se borxhi nuk ishte i zbatueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit⁶. Sipas Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve (LMD), *“Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.”*⁷ Gjikata gjithashtu vërtetoi se as KRU “Prishtina” dhe as ARRU nuk kanë paraqitur prova që të tregojnë se kanë ndërmarrë ndonjë veprim ligjor lidhur me kërkesën për përmbushjen e borxhit. Po ashtu, sipas LMD-së, *“për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton thjesht që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin.”*⁸

Gjikata shqyrtoi pretendimet e të paditurave po ashtu, por i hodhi poshtë ato si të pabazuara, duke theksuar se të paditurat kishin për obligim që të verifikonin periudhën e ndryshimit të pronarit të ngastrës kadastrale në bazë të kontratës së shitblerjes. Nga kjo periudhë, duhej të njoftohej konsumatori i ri për ndryshimet dhe faturimi për shpenzimet e ujit duhej të bëhej në emër të pronarit të ri, duke lejuar regjistrimin me orëmatës të ri. Për më tepër, borxhi për shpenzimet e ujit për periudhën kontestuese duhet të shlyhet, pasi është konsideruar borxh i parashkruar.

Si përfundim, gjykata mori vendim meritore në favor të paditësit B.R., duke anuluar vendimet e ARRU-së dhe KRU “Prishtina,” dhe detyruar kompaninë KRU “Prishtina” të shlyejë borxhin e parashkruar të ngarkuar në emër të paditësit për periudhën 2000–2023, si dhe duke kërkuar nga ajo që t’i lejojë regjistrimin me ujëmatës të ri në emër të paditësit⁹.

6 *Borxhi i parashkruar është një borxh që nuk mund të kërkohet ligjërisht për shkak se ka kaluar një periudhë e caktuar kohore, e cila njihet si afati i parashkrimit.

7 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhënien e Detyrimeve, neni 341, paragrafi 2. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828>

8 Po aty. Neni 372.

9 Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.2781/2021, datë: 30.04.2024

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky raport i shkurtër trajton dy raste të padive në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të ngritura nga dy qytetarë të Republikës së Kosovës. Rasti i parë përfshin një padi ndaj ZRRE, ndërsa në rastin e dytë, pala paditëse ka paditur dy institucione: KRU Prishtina dhe ARRU. Raporti thekson sfidat me të cilat përballen qytetarët në trajtimin e vendimeve administrative dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë përballjeve me institucionet publike. Po ashtu, shqyrtohet procedura e ankesave në dy shkallët e autoriteteve publike, kohëzgjatja e rasteve që nga iniciimi i tyre në gjykatë deri te shqyrtimi dhe shkeljet ligjore.

Në rastin e parë, vendimi i gjykatës për ta kthyer çështjen për rishqyrtim tregon joefikasitet në sistemin aktual, i cili shpeshherë zgjat procesin ligjor. Me Ligjin e ri për Konfliktet Administrative¹⁰, që pritet të hyjë në fuqi në janar 2024, do të ndalohet kthimi i rasteve për rishqyrtim dhe rivendosje tek organet publike. Ky ndryshim pritet të reduktojë kohën e zgjidhjes së rasteve. Po ashtu, me këtë ligj do të rregullohet procedura e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, duke përfshirë edhe fuqinë ligjore që do ta kenë gjyqtarët për të shqiptuar gjopa ndaj zyrtarëve përgjegjës. Në rastin e dytë, gjykata ka marrë një vendim meritore në favor të paditësit kundër institucionit publik KRU Prishtina. Ky rast, i cili ka zgjatur më shumë se tri (3) vite, mund të shërbejë si shembull motivues për qytetarët që të kërkojnë të drejtat e tyre dhe të mos heqin dorë nëse ato u shkelen nga ndonjë institucion shtetëror.

Në të dyja rastet, gjykata ka theksuar rëndësinë e respektimit të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, veçanërisht kërkesën që vendimet e autoriteteve publike të jenë të arsyetuara mirë dhe të mbështetura në prova. Kjo nënvizon nevojën që autoritetet publike të përmirësojnë proceset e tyre të vendimmarrjes, duke siguruar që të ndjekin kuadrin ligjor për të shmangur vonesat dhe mosmarrëveshjet e panevojshme. Bazuar në sfidat e evidentuara nga monitorimi i këtyre dy rasteve, rekomandohet që:

- Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative, institucionet shtetërore të organizojnë trajnime për gjyqtarët, avokatët, profesionistët ligjorë dhe të tjerë, me qëllim që të sigurohet zbatim efikas i këtij ligji.
- Të zbatohet në mënyrë të plotë Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Në veçanti, organet publike duhet të ofrojnë vendime të arsyetuara dhe të mbështetura në prova, sipas kërkesave të neneve 47 dhe 48 të këtij ligji.
- Institucionet përgjegjëse të marrin masa ndaj zyrtarëve që janë përgjegjës për trajtimin e ankesave dhe që nuk respektojnë dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. I qasshëm te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85181>